



---

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.5, 15.1 (c) dhe nenit 21.2 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil,

Duke pasur parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (të referuar më tej si "Marrëveshja për HPEA") në emër të Kosovës, nga ana e UNMIK-ut, si dhe hyrjen e përkohshme në fuqi të Marrëveshjes për HPEA për Kosovën, më 10 tetor 2006,

Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës ka pranuar obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë edhe ato të konkluduara në emër të saj nga UNMIK-u,

Duke pasur parasysh obligimin nga Marrëveshja për HPEA, që Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1330/2007 e datës 24 shtator 2007 që përcakton rregullat implementuese për shpërndarje palëve të interesuara të informatave për ndodhitë në aviacionin civil të referuara në Nenin 7(2) të Direktivës 2003/42/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Europian, duhet të bëhet pjesë e rendit të brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 09/2010 PËR  
RREGULLAT IMPLEMENTUESE PËR SHPËRNDARJE PALËVE TË  
INTERESUARA TË INFORMATAVE PËR NDODHITË NË AVIACIONIN CIVIL  
TË REFERUARA NË NENIN 7(2) TË DIREKTIVËS 2003/42/EC TË  
PARLAMENTIT DHE TË KËSHILLIT EUROPIAN**

*Neni 1*

1.1 Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1330/2007 e datës 24 shtator 2007 që përcakton rregullat implementuese për shpërndarje palëve të interesuara të informatave për ndodhitë në aviacionin civil të referuara në Nenin 7(2) të Direktivës 2003/42/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Europian, e referuar më tej si Rregullorja e Komisionit, me këtë deklarohet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1330/2007 i është bashkangjitur si aneks kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

1.2 Dispozitat e neneve 1 deri 10, Aneksat I dhe II të Rregullores së referuar të Komisionit janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

1.3 Çdo dispozitë e amendamenteve të Rregullores së Komisionit, të përfshira në Shtojcën I të Marrëveshjes për HPEA, do të jenë drejtpërdrejt të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

#### *Neni 2*

2.1 Përkufizimet e termave dhe shprehjeve të përdorura në këtë Rregullore janë ato të përdorura në nenin 2 të Rregullores së Komisionit.

2.2 Pavarësisht nga paragrafi 1, termat “Komuniteti”, “ligji i Komunitetit”, “legjislacioni i Komunitetit”, “instrumentet e Komunitetit”, “Traktati i KE”, “aerport i Komunitetit”, “Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane”, “Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian”, “transportues ajror i Komunitetit” dhe “Shtet(e) Anëtar(e)”, nëse referohen në Rregulloren e Komisionit, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Aneksit II të Marrëveshjes për HPEA.

2.3 Për qëllime të kësaj Rregulloreje “autoritet kompetent”, siç referohet në Rregulloren e Komisionit, sa i përket Republikës së Kosovës nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

#### *Neni 3*

Në rast të ndryshimit të verzioneve të përkthyer në gjuhët shqipe dhe apo serbe me verzionin origjinal në gjuhën angleze të Rregullores së Komisionit, (EC) Nr. 1330/2007 versioni në gjuhën angleze, siç është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian do të ketë përparësi.

#### *Neni 4*

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 nëntor 2010.

**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtori i Përgjithshëm